REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

PROJEKT VENDIM
Nr. _____ datë _____. _____ . 2025

"Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 në Bashkinë Kavajë"

Në mbështetje të nenit Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligjit nr. 68/2017, datë 24.04.2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" i ndryshuar; ligjit nr.9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" me ndryshimet përkatëse në ligjin nr. 181/2013, datë 28/12/2013; ligjit nr. 142/2015, datë 17.12.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar"; ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar; ligjit nr. 107/2014."Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"; VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" i ndryshuar; ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për Legalizimin,Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje" i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Repuplikës së Shqipërisë",i ndryshuar; ligjit nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Repuplikën e Shqipërisë";VKM nr. 649, datë 16.10.2024 "Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit"; ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative; ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak:

TË VENDOSË :

I- Të miratojë sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 në Bashkinë Kavajë.

II- Ngarkohen drejtoritë përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

DREJTORIA LIGJORE
Helidon Plaku

DREJTORIA E KADASTRËS URBANE, MENAXHIMIT TË ASETEVE PUBLIKE
Izmir Proshka

DREJTORIA E BURIMEVE EKONOMIKE
Albi Lushka

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Dëshira QATO

DREJTORIA E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE STREHIMIT
Izmir Hoxha

DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE
Florian MERHORI

DREJTORIA E KULTURËS DHE SPORTEVE
Gentian JAUPI

DREJTORIA E TRASHËGIMISË KULTURORE DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT
Bashkim KRASNIQI

DREJTORIA E SHËRBIMEVE
Marjus KOLA

DREJTORIA E NDRIÇIMIT DHE TRANSPORTIT
Baki DERVISHI

DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Ibrahim SKUQI

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL
Xhulja UZUNI

DREJTORIA E ÇERDHEVE DHE QENDRA DITORE
Romina KALA

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
Frida GJUZI

DREJTORIA E PROKURIMEVE DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE
Klajdi MYFTIU

AGJENCIA E ARSIMIT PARASHKOLLOR
Edmond ÇURUMI

DREJTORIA E TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE TË ARDHURAVE DHE BORXHIT
Jurgen KARIQI

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Meri BITURKU

KRYETARI
FISNIK QOSJA

PROPOZIM PËR DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E TAKSËS/TARIFËS PER VITIN 2026

RELACION SHPJEGUES

Të nderuar këshilltarë, pjesëmarrës,

Vendimi për nivelin e taksave dhe tarifave vendore që do të aplikohen përgjatë vitit 2026 është një nga dokumentet më thelbësore dhe më të rëndësishme të Bashkisë Kavajë.

Hartimi i saj është shumë kompleks pasi në përfundim të procesit të hartimit të saj, rezultati duhet të jetë një paketë fiskale e aplikueshme dhe e integruar në të gjithë territorin e Bashkisë Kavajë.

Projekt paketa fiskale per vitin 2026 nuk planifikon të kete ndryshime te shumta.

Ne lidhje me taksat dhe tarifat vendore qe aplikohen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ndaj subjekteve nuk planifikohen të kryhen ndryshime. Aktualisht duke marrë në konsideratë faktin se në vitin 2025 u aplikuan ndryshimi në nivelin e tarifës së pastrimit për disa kategori subjektesh, synohet stabilizimi dhe zbatimi me përpikmëri i taksave dhe tarifave si dhe maksimizimi i të ardhurave nga to, ndaj dhe sugjerohet që niveli i tyre të mos ndryshojë për vitin në vijim.

Edhe parashikimet e të ardhurave janë mbajtur në nivele realiste, duke u bazuar në performancën faktike të viteve të fundit, në mënyrë që të shmanget mbivlerësimi dhe mosrealizimi gjatë ekzekutimit të buxhetit. Megjithatë, administrata e bashkisë po punon për të rritur efiçencën e mbledhjes së të ardhurave përmes përmirësimit të administrimit tatimor lokal, dixhitalizimit të shërbimeve dhe luftës kundër informalitetit. Këto masa pritet të sjellin rritje graduale të të ardhurave vendore edhe pa ndryshuar nivelin e tarifave dhe taksave.

Ndryshimet që propozohen ne kete Projekt pakete i referohen ndryshimeve të fundit ligjore, pikerisht Udhezimit nr.1 datë 10.9.2025 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2025", e cila ka paraqitur ndryshime në koston e ndërtimit nga 32,105 lekë/m2 për sipërfaqe ndërtimi në 47,378 lekë/m2. Kjo ka sjellë si domosdoshmëri edhe ndarjen e zonave përsa i përket kërkesave të ndërtimit, e cila në në përpjestim të drejtë kërkon edhe investime në infrastructure, pra angazhimin e njësisë vendore për të ofruar më shumë shërbime. Kërkesat për ndërtime në Bashkinë Kavajë dhe zonen turistike janë rritur ndjeshëm ndërkohë që kërkesa për ndërtime të reja në qendrat e banuara rurale nuk ka pësuar ndryshime. Ndarja e zonave sipas zhvillimit urbanistik sjell si domosdoshmeri ndryshimin e nivelit te takses se ndikimit ne infrastrukture, konkretisht rritjen e saj ne zonat me perparesi zhvillimi si zona turistike e Golemit dhe Qyteti i Kavajes.

Thënë qartë propozohen këto ndryshime

1- Propozohet ulje në taksën e ndikimit në infrastrukture për objektet e ndërtimit me qëllim banimin për zonat rurale nga 5 % në 4%, pra ulje e nivelit me 1 %.

2- Për ndertime individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë për vitin 2026 propozohet të rritet me 0.5 % vetëm për qytetin e Kavajës dhe zonën turistike. Për këto zona propozohet ndryshimi i nivelit të kësaj takse nga 2.5 % në 3%.

3- Për shkak të kërkesës është shtuar në këtë Projekt Paketë, taksa e ndikimit në infrastrukture për Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë si Kapanone, Magazina, konstruksione te tjera etj.e cila propozohet në masën 3% të vlerës së preventivuar.

4- Si dhe propozohet per shkak të ndryshimeve ligjore, aplikimi i taksës së ndikimit në infrastrukture në masë 1% të vlerës së investimit, për Ndertime qe destinohen per funksione te bujqesise sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave"i ndryshuar me Ligjin nr. 67/2023, datë 21.07.2023 ,Neni 2.

(Neni 2: "Për subjektet që janë në proces aplikimi për t'u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj.)

Te ardhurat nga kjo takse synohen të perdoren pikerisht per kete qellim, pra per rritjen e investimeve ne keto zona dhe ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe cilesore.

Të ardhurat e realizuara nga taksa e ndikimit në infrastrukture për vitin 2025 kanë tejkaluar pritshmëritë duke ndikuar pozitivisht në të ardhurat totale të Bashkisë Kavajë. Ato përbëjnë rreth 65 % të totalit të ardhurave të vetë bashkisë.

Ndërkohë janë propozuar ndryshime edhe në nivelin e tarifave për aplikimet e kryera për leje ndërtimi si dhe për akt kontrollet që duhet të kryhen ligjërisht pranë çdo objekti të ndërtuar, pasi keto kontrolle kerkojne angazhimin e specialisteve ne terren dhe rritjen e kostove per bashkine.

Propozimi tjetër për ndryshim vjen nga Drejtoria e Ndriçimit dhe Transportit, në lidhje me licencat të cilat duhet të jepen për subjektet që disponojnë automjete për transportin e udhëtarëve/pasagjerëve brenda vendit, dhe që nuk janë paraqitur në Paketat e mëparshme fiskale. Kjo lind si domosdoshmëri prej kërkesave të paraqitura në këtë drejtori si dhe referuar ligjeve në fuqi për zbatimin e tyre. Kjo prek drejtpërsëdrejti hotelet pasi pjesa me e madhe e tyre kanë të përfshirë një automjet i cili përdoret për nevojat e transportit të punonjësve dhe si pasojë këto automjete referuar ligjit per transportin duhet te pajisen me licence për qarkullimin e tyre.

Ndërkohë që referuar ndryshimeve ligjore propozohet rritja e numrit të fletëve të udhëtimit për librat e udhëtimit nga 10 në 25 fletë ,për shoqëritë e transportit të udhëtarëve pa ndryshuar nivelin e tarifës I cili ka qenë 5000 lekë për libër udhëtimi dhe vazhdon të mbetet e njëjtë.

Procesi i hartimit të paketës fiskale, kalon nëpër fazat si më poshtë:

- Krijimi i një grupi të përbashkët të punës për hartimin e paketës fiskale.
- Përcaktimi i bazës ligjore dhe dokumentave që do t'u referohemi.
- Vlerësimi i situatës për hartimin e propozimeve konkrete.
- Konsultim i propozimeve të paketës fiskale me përfaqësues të grupeve të interesit dhe biznesit.
- Finalizimi i proçesit të hartimit të paketës fiskale dhe dërgimi për miratim pranë Këshillit Bashkiak.

Grupi i punës:

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar titullarët e Bashkisë, të gjitha drejtoritë dhe ndërmarjet e varësisë.

Konsultimi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Kavajë janë zhvilluar takime me grupe interesi sipas datave të caktuara në kalendarin e publikuar:

1. Me banorë dhe grupe interesi në qytet dhe njësi administrative
2. Me përfaqësues të biznesit të vogël
3. Më përfaqësues të biznesit të madh

Çfarë synon kjo paketë fiskale:

a) Aplikimin dhe përditësimin e bazës ligjore të ndryshuar;

b) Përditësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për vjeljen e çdo takse dhe tarife, pjesë e kësaj pakete fiskale.

c) Përmirësimin e sistemit fiskal efiçent dhe transparent;

d) Përcaktimin e qartë në seksione të taksave dhe tarifave.

Referuar sa më sipër konkretisht, Kryetari i Bashkisë:

Propozon:

1- **Në faqen nr. 18,** ndryshim për ndarjen e zonave sipas përparësisë dhe zhvillimit urbanistik, duke iu referuar dispozitave ligjore për kostot e ndërtimit, konkretisht Udhezimit nr.1 datë 10.9.2025 për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2025", duke bërë ndarjen e dy zonave, Bashkia Kavajë dhe zona turistike si dhe qendrat e banuara rurale

2- Propozohet ndryshimi i nivelit aktual të taksës së ndikimit në infrastrukturë për rastet e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, duke e **ulur me 1 % nivelin e taksës për qendrat e banuara rurale, pra nga 5 % në 4%** .

3- Për ndërtimet individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind të vlerës së preventivit, **propozohet rritja me 0.5 %**, pra **ishte 2.5 % propozohet 3 %,** niveli e kësaj takse për ndërtimet në Bashkinë Kavajë si dhe zonën turistike, ndërkohë që ka mbetur i pandryshuar niveli i taksës për qendrat e banuara rurale.

4- Propozohet shtim i një kategorie të re "Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë si Kapanone, Magazina, konstruksione te tjera etj." me nivel takse të propozuar prej 3%, referuar vlerës së preventivit të punimeve.
5- Është shtuar kategori e re "Ndertime qe destinohen per funksion te bujqesise" me nivel takse të propozuar prej 1 % të vlerës së preventivit të punimeve"

Tabelë 9. Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja aplikuar për vitin 2025

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës
	Në përqindje
1. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga *shoqëri ndërtimi,* shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori të investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të lejëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesioni, të cilat prek banesat ekzistuese. Gjithashtu në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave(VKM Nr.168, datë 27.03.2019)	5%
2. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së preventivit dhe : a)për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastructure është 1 deri në 3 përqind e vlerës së preventivit	3%
3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe : a)për ndërtime në funksion të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind të vlerës së preventivit	2,5%
4. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet p ër këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 përqind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk përfshihet në preventivin e investimit	0,1%
5. Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.	-

Tabelë 9. Nivelet e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja propozuar për vitin 2026

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njesia	Niveli i TNI ne %	
		Per Bashkine Kavaje dhe zonen turistike	Në përqindje Per qendrat e banuara rurale
1. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga *shoqëri ndërtimi,* shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave:Udhezim nr.1 datë 10.9.2025 për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave, për vitin 2025"	Ne % te cmimit te shitjes per m^2 sipas kostos mesatare te cmimit te shitjes	5%	4%
2. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së preventivit (vleres se investimit") dhe : a)për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastructure është 1 deri në 3 përqind e vlerës së preventivit	Në % të vlesës së investimit (preventivit te punimeve te deklaruar nga inxhinieri preventivues)	3%	3%
3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe : Ndertime individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 përqind të vlerës së preventivit	Në % të vlesës së investimit(preventivit te punimeve te deklaruar nga inxhinieri preventivues	3%	2,5%
4. Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfs hirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e n dikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 përqind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk përfshihet në preventivin e investimit	Në % të vlesës së investimit (preventivit te punimeve te deklaruar nga inxhinieri preventivues	0.1%	0,1%

5 Ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e industrisë si Kapanone, Magazina, konstruksione te tjera etj.	Në % të vlesës së investimit (preventivit te punimeve te deklaruar nga inxhinieri preventivues	3%	3%
6. Ndertime qe destinohen per funksion te bujqesise. LIGJ Nr.9632, datë 30.10.2006 Ligji 67/2023 Datë 21.07.2023 Neni 2.	Në % të vlesës së investimit (preventivit te punimeve te deklaruar nga inxhinieri preventivues	1%	1%
7 Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave, të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Nga pagesa e kësaj takse përjashtohen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.	-		

6- Në **faqen 34**, Tabelë 22. Nivelet e tarifës për kontrollin e zhvillimit të territorit propozohen ndryshimet paraqiten si më poshtë:

II.8– b) Tarifa për kontrollin e zhvillimit të territorit	**Njësia**		**Niveli i tarifës**
		Ishte	***Propozohet***
1-Për të gjitha llojet e aplikimeve per leje ndertimi a- për shtëpi banimi b- për nevoja biznesi	 lekë /aplikim lekë /aplikim	 3000 10000	 3000 50000
2-Tërheqje dokumentash të njehsuara me origjinalin	lekë /dosje	500	500
3-Akt Kontroll për piketimin e objekteve deri 3 kat mbi tokë	lekë/kontroll	3000	3000
4-Akt Kontroll për piketimin e objekteve mbi 3 kat mbi tokë	lekë/kontroll	5000	10000
5-Akt Kontroll pas përfundimit të themeleve deri në 3 kat mbi tokë (kuota 0.00)	lekë	3000	5000
6-Akt Kontroll pas përfundimit të themeleve mbi 3 kat mbi tokë (kuota 0.00)	lekë	5000	15000
7-Akt Kontroll pas përfundimit të karabinasë për të gjithë objektin	lekë	5000	15000
8-Akt kontrolli për përfundimin të strukturës së re deri në 3 kat(akt kontrolli përfundimtar)	lekë	3000	5000
9-Akt kontrolli për përfundim punimesh të strukturës së re mbi 3 kat (akt kontroll përfundimtar)	lekë	5000	20000

10-Azhornim i genplaneve për leje ndertimi per statuset jo truall	lekë /m^2	50	50
11-Leje Përdorimi	lekë/m^3	30	30
12-Deklarate paraprake (2,5% e vlerës së preventivit për banesë dhe 3 % e vlerës së preventivit për shërbime)		Sipas Preventivit	Sipas Preventivit

Propozohen ndryshime në aplikimet për leje ndërtimi për nevoja biznesi, dhe per të gjitha akt kontrollet e kryera nga specialistët e kësaj drejtorie.

Duke marrë në konsideratë Vendimin e Kryetarit të Bashkisë 01/3 , datë 15.09.2025, për miratimin e strukurës organizative të Bashkisë Kavajë për vitin 2025, janë ristrukturuar disa drejtori nga ku Drejtoria e Ndriçimit dhe Transportit me qëllim detajimin dhe funksionimin sa më të plotë të saj propozon shtesat si më poshtë :

a- Në faqen 37, në kategorinë I, TRANSPORT UDHËTARËSH Brenda Vendit, shtohet pika 6 "Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara, të transportit të udhëtarëve brenda vendit" si dhe certifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara, të transportit të udhëtarëve brenda vendit, si dhe ndryshohet nr.i fletëve të udhëtimit nga 10 në 25, duke mos e ndryshuar vlerën fillestare të librit, referuar me vlerat respektive sipas tabelës më poshtë:

II.9– f) Kategoritë, nënkategoritë	**Njësia**	**Niveli i tarifës (në lekë)**
		Afati 5 vjeçar
I TRANSPORT UDHËTARËSH ***Brenda vendit***		
6- Licencë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara, të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Për licencë	40000
-Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara, të transportit të udhëtarëve brenda vendit	Për mjet	7500
IV VEPRIMTARI TË TJERA		
1- Libri i udhëtimit për shërbime turistike të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr.fletëve/nr.udhëtimeve 25)	Për libër	5000

Duke ju falenderuar sërisht për pjesëmarrjen tuaj!

DREJTORI I TAKSAVE, TARIFAVE VENDORE
TË ARDHURAVE DHE BORXHIT
Jurgen Kariqi